



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Datë/a:	17.3.2025
Referenc-ë:	01-030/01-38372/25, më 17.3.2025
Për/ Za/ To:	Publikun e Komunës së Prishtinës
Nga/ Od/ From:	Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit
Lënda:	Njoftim për publikun



Në bazë të nenit 45.2 të Ligjit nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008, e njoftojmë publikun se më datë 28.3.2025, në ora 10:00, në Sallën e madhe të mbledhjeve në objektin e vjetër të Komunës, mbahet seanca e tretë e Kuvendit të Kryeqytetit, me këto pika të rendit të ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së parë dhe të dytë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begolli;
3. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve: Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi;
4. Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
5. Propozim-vendimi për definimin e kufirit në mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues "Prishtina e Re- Zona Qendër";
6. Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues - Çagllavicë;
7. Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve;
8. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për shoqatën "Yjet që nuk vdesin";
9. Raport financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 30 dhjetor 2024 (TM4);
10. Raport financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024;
11. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
12. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;

13. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, nr- 01-020/05-69249/23. dt. 3.4.2023;
14. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
15. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;
16. Pyetje dhe përgjigje;
17. Të ndryshme.